



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 537 Prot.

Roskovec, më 29.01 2020

VENDIM

NR 7 .DATË 24.01 .2020

**“PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE PYJE/KULLOTA QË
TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË BASHKISË ROSKOVEC”**

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjes Vendore”, neni 27 , pika 5, neni 54 , gërma "k" ; Ligji nr.8743, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, i ndryshuar; neni 6 , pika 2 , gërma b, Ligji nr.8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar; Ligji nr. 111/2018 “Per kadastrën”, neni 2 , gërma c, neni 69 , pika 5, ,VKM nr.500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore” i ndryshuar; VKM Nr.433 datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish- komunave/ bashkive”, pikat : 1, 24, 66, 67 dhe 68, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

- 1- Miratimin e Listës së Inventarit të Pronave të Pyjeve/Kullotave që transferohen në pronësi të Bashkisë Roskovec.
- 2- Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi, duke ndjekur procedurat përkatëse ligjore për miratimin e listës së këtij inventari nga Këshilli i Ministrave nëpërmjetë ASHK-së.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Kadri Hyska

